


JeToJ

FUSHAT E JETËS



Marrim Pjesë për një

Shoqëri më të Larmishme

pa barriera

pa barriera

pa barriera

pa barriera



Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar

Këshilli kombëtar i aftësisë së kufizuar,
ka dhjetë ministra dhe 7 anëtarë shoqatash,
përfaqësues të shoqatave që merren me aftësinë e kufizuar.

Këshilli propozon ndryshime ligjore,
por gjithashtu dhe vëren zbatimin e ligjeve.

Pas shumë vitesh përpjekje sot kemi një ligj
që ndihmon në punësimin e personave me aftësi të kufizuar
pasi çdo biznes që merr në punë persona me aftësi të kufizuar
merr aq pagesë sa është rroga minimale për 6 muaj
dhe sigurimet shoqërore për një vit.

Këshilli Kombëtar ka rënë dakord se ditët e sotme
është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuar
të përfshihen në mënyrë aktive.

Për këtë arsye edhe ato që do bëhen 5 vitet e ardhshme
do kenë në qendër të vëmendjes përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar
në çdo gjë, në ëdo vendim

Asgjë për ne, pa ne!

Përgatiti: Darjan Konomi

Aftësimi për jetën

Aftësimi për jetën është një aktivitet i rëndësishëm në qendër.

Me këtë program synojmë të aftësohemi për një jetesë të pavarur në qytetin ku jetojmë.

Programi ka mësim të teorisë, ku ne mësojmë shenjat rrugore si dhe mësojmë se si duhet të lëvizim duke u kujdesur gjithnjë.

Ne mësojmë gjithashtu se ku duhet të drejtohemi për të marrë dokumentat tona.

Në praktikë ne kemi kryer udhëtime me autobus kemi vizituar institucione lokale duke parë vetë se si merren nga njësia administrative dokumenta bazë që na nevojiten.

Gjithashtu ne kemi kryer vizita në qendra tregtare duke marrë pjesë në mënyrë aktive në blerje.

Ne kemi vizituar edhe disa farmaci dhe institucione të tjera lokale, si policia duke mësuar ku mund të adresohemi në rast problemesh.

Sot ne kuptojmë

se aftësimi për të kryer gjera vetë na ndihmon për një jetë më të mirë.



Përgatiti: Sokol Qiriçi

Jetesa e pavarur nuk është e mundur pa mbështetje

Një hamendësim i zakonshëm për jetesën e pavarur është se personat me aftësi të kufizuar duhet të jenë në gjendje të jetojnë më vete dhe t'i bëjnë gjërat vetë pa mbështetje nga të tjerët.

Për këtë arsye, personat që kanë nevojë për më shumë mbështetje konsiderohen si raste shumë të rënda për të jetuar në komunitet.

Jetesa e pavarur nënkupton se mbështetja që një person merr duhet të bazohet në dëshirat, nevojat dhe stilin e tyre të jetesës.

Personat me aftësi të kufizuar nuk duhet t'u përshtaten shërbimeve ekzistuese por shërbimet duhet të jenë të tilla për t'ju përgjigjur kërkesave të çdo personi.

Jetesa e pavarur duhet të marrë parasysh të gjitha sferat e jetës të një personi.

Këtu përfshihet punësimi, arsimi, dhe të qëniet pjesë e komunitetit lokal.

Mbështetja e jetesës së pavarur nuk mbulon vetëm nevojat bazë të një personi por dhe i ndihmon për të marrë informacion, këshillim dhe shërbime mbrojtjeje.

Në jetesën e pavarur, mbështetja drejtohet dhe kontrollohet nga personi me aftësi të kufizuar dhe nuk diktohet nga ofruesi i shërbimit.

Kjo do të thotë se personi me aftësi të kufizuar vendos për kujdestarin personal dhe se çfarë mbështetje i duhet, ku i duhet dhe kur i duhet.



WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Shërbimi në qendër



Shërbimi në qendrën ditore është shumë i rëndësishëm.

E nisëm këtë shërbim si një gjë të re në Shqipëri duke menduar se shërbimet në komunitet janë mënyra më e mirë për përfshirjen e personave me aftësi ndryshe në Shqipëri.

E nisëm duke parë aftësitë e secilit dhe duke zgjedhur më pas duke u bazuar te këto aftësi aktivitetin që i përshtatej.

Fillimi si çdo gjë e re ishte i vështirë, por ne nuk u trembëm asnjëherë.

Që në vitin e parë të qendrës futëm një fëmijë në shkollë.

Më pas pasi pamë aftësitë ne bëmë disa aktivitete në grup si pjesëmarrje në olimpiadën speciale teatër, takime në komunitet dhe aktivitete brenda qendrës si punë me dru, pikturë, edukim dhe rrobaqepësi.

Sot personat që vijnë në qendër po mësojnë të lëvizin në qytetin ku jetojnë, të prezantojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre dhe mbi të gjitha disa prej tyre janë duke bërë praktikën e punës.

Disa prej tyre do jenë tani të aftë për punësim dhe kjo tregon rëndësinë dhe suksesin e kësaj qendre.

Përgatiti: Jonida Dashi

E drejta për informim

E drejta për informim është një e drejtë që u takon të gjithë njerëzve pa përjashtim.

Kjo do të thotë se personi që e ka informacionin është i detyruar ta japë atë.

Ti ke të drejtë të kërkosh informacion pa qenë i detyruar të shpjegosh pse e do atë.

Megjithatë, në qoftë se informacioni i kërkuar prej teje përbën të dhëna që janë sekret për njerëz të tjerë, ti nuk ke të drejtë ta dish këtë informacion pa lejen e atyre njerëzve.

Kush janë personat e detyruar të të informojnë?

Ata janë punonjësit e zyrës të shtetit.

Punonjësi i zyrës të shtetit është i detyruar të të tregojë nëse ai e ka informacionin që ti po kërkon.

Kërkesa për informacion duhet të bëhet me shkrim.

Punonjësi i zyrës së shtetit është i detyruar të të kthejë përgjigje sa më shpejt.

Afati i fundit për kthimin e përgjigjes është 10 ditë nga data e dërgimit të kërkesës nga ana jote.

Mund të ndodhë që kërkesa jote të jetë dërguar në adresën e gabuar.

Kjo do të thotë se punonjësi i shtetit që ti ia ke nisur kërkesën nuk e ka informacionin që ti do.

Në këtë rast ti nuk duhet të shqetësohesh. Punonjësi i shtetit do t'ia nisë kërkesën tënde asaj zyre që e ka informacionin.

Ai do të të lajmërojë ty për këtë veprim brenda 15 ditëve.

Nëse kërkesa jote punonjësit të zyrës së shtetit i duket e paqartë, ai kërkon takim me

ty për ta sqaruar kërkesën brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës tënde.

Në këtë rast, punonjësi e ka për detyrë të të ndihmojë ty për ta rregulluar kërkesën.

Ti ke të drejtë që, edhe kur kërkon kopje të dokumenteve zyrtare, t'i marrësh ato pa pagesë.

Ti ke të drejtë që informacionin ta kërkosh në një format që je në gjendje ta marrësh dhe ta kuptosh.

Nëse je i verbër, informacionin e kërkon në shkrimin për të verbër, që quhet Brail që lexohet me anë të prekjes me gishta, ose në format audio, domethënë të regjistruar me zë në një disk, në mënyrë që ta dëgjojë.

Nëse je person me aftësi të kufizuara mendore, informacionin duhet ta kërkosh me tekst sa më të thjeshtë, që të jesh në gjendje ta kuptosh atë.

Nëse shteti nuk ta jep informacionin pa të drejtë, ti i ankoresh Komisionerit për Informimin brenda 30 ditëve nga kalimi i kohës kur duhej të kishe marrë përgjigje ose nga përgjigjja se informacioni nuk do të të jepet nga punonjësi i shtetit që i je drejtuar.

Komisioneri të jep përgjigje brenda 15 ditëve.

Në qoftë se as përgjigjja e Komisionerit nuk të kënaq, atëherë i drejtohesh gjykatës administrative.

Në fund të themi se ligji dënon shumë rëndë ata që nuk ta japin informacionin pa të drejtë, prandaj mos ki frikë të kërkosh informacion!



WITH FUNDING FROM

AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Përgatiti: Stefan Paloka

Profil konsulenti



Emiljano Prelashi

Ai është 30 vjeç, lindur dhe banues në Laç. Shkollën e mesme e ka mbaruar në qytetin ku jeton, si dhe ka përfunduar studimet e larta në degën Anglisht pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Univeristetin e Shkodrës.

Aktualisht është i angazhuar si konsulent pranë Qendres së këshillimit Laç, kjo si një eksperience e tij e parë në pjesëmarrje të projekteve për PAK.

Gjatë angazhimit të tij si konsulent dhe pjesëmarrjes nëpër aktivitete të Qendrës, iu dha mundësia që në fushatën “E drejta për informim” të njihet me të drejtat për fillimin e stazhit të mësuesisë.

Kjo u finalizua me arritje dhe fillimin e stazhit si mësues i gjuhës angleze pranë gjimnazit “At Shtjefën Gjeçovi” Laç.

Puna e tij pranë qendrës, përveç konsulencës me PAK është vënë dukshëm edhe me nxënësit me AK në shkollën ku kryen stazhin, për të cilët shihet si një shembull pozitiv dhe nxitës për ta.

Ka pasion sportin dhe aktivitetet sportive, ku sigurisht është gjithmonë i gatshëm dhe i pranishëm.



Gëzim Lleshi

Ka lindur në fshatin Tuç të Rrethit Pukë.

Ai është 35 vjeç dhe ka përfunduar shkollën 8-vjeçare në Burrel.

Tashmë është banues në Laç, ku jeton me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij.

U diagnostifikua që në moshën 15-vjeçare me distrofi muskulare progresive. Është i angazhuar si konsulent pranë Qendres së këshillimit Laç, eksperience e parë e tij me persona me AK. Puna e tij ka qënë e dukshme në konsulencën me PAK të tjerë por shpesh herë edhe si ideator dhe referues aktiviteteve.

Gjatë fushatës “Mjedis pa barriera” ka qënë moderator, ku nxorri në pah vlerat e tij. Kjo ishte një shtysë për rritjen e vetvlerësimit të tij për të marrë nisma të tjera të këtij lloji. Si pjesë e qendrës këshillimore në aktivitete të vazhdueshme ka marrë iniciativën dhe organizimin për aktivitete të kohës së lirë, bisedë grupi “Diversitet jashtë, vlerë e njëjtë brenda”. Gjatë referimit të tij dhe bashkëbisedimit të PAK të tjerë, u vu re një përkrahje dhe pozitivitet. Ka pasion punën me kompjutera.

Profil konsulenti



Lin Murri

Unë quhem Lin Murri, kam lindur në vitin 1971 në fshatin Naraç të Bashkisë Vau-Dejës.

Kam përfunduar shkollën 8-vjeçare në fshatin tim.

Unë që në moshën 1 vjeçare jam diagnostikuar me poliomelet, kjo ka qënë dhe një ndër arsyet pse unë nuk kam arritur të vazhdoj shkollën dhe as nuk arrita të kryej shërbimin ushtarak si gjithë shokët e mi.

Në vitin 2005 unë bëra një aksident, ku mbeta i paralizuar dhe për 2 vite qëndrova në një karrige me rrota. Gjatë këtyre dy viteve unë kam qëndruar vetëm mbyllur në dhomën time, oborrin e shtëpisë e shikoja vetëm nga dritarja.

Pas aksidentit kam bërë pesë operacione,

të gjitha këto të kryera me borxhe.

Kjo gjë e bëri edhe më të vështirë jetesën e familjes time, u vështirësua shumë gjendja ekonomike, psikologjike, emocionale e morale e çdo pjesëtari, nga më i vogli tek më i madhi.

Kam qëndruar 6 vite i izoluar nga shoqëria, komuniteti e të afërmit e mi.

Nuk shkoja në asnjë rast familjar e nuk doja të më vinte askush.

Depresioni, mërzitja me jetën, frika, varfëria dhe lotët kanë qënë të vetmit miq për vite me rradhë.

Pas 6 vitesh të errëta, Zoti më dergoi ëngjëjt e tij (stafin e Caritas-it), të cilët me ndihmën e Zotit e me dëshirën e tyre të madhe, janë munduar në çdo çast që të jenë pranë meje dhe familjes time në çdo mënyrë, duke më bërë pjesë të çdo aktiviteti të Caritas-it. Në vjeshtën e vitit 2015 mora lajmin më të bukur të jetës time nga Caritas-i, për herë të parë do të punoja. Ata më folën për projektin “Pa barriera”, për rolin e Konsulentit.

Me dëshirën më të madhe e pranova këtë punë, doja me patjetër që fëmijët e mi të ndiheshin krenarë, që babai i tyre arrin të punojë. Ndjehem shumë fatlum që jam pjesë e këtij projekti, kam mësuar shumë. Më është rritur vetë-besimi në sajë të marrjes së informacioneve mbi të drejtat. Jam më aktiv në komunitet, kam krijuar një shoqëri, disa miq që mund të flas e të bashkëndaj çdo gjë me ta, të mirën e të keqen.

Ndjehem i aftë të marr përgjegjësi, ndjehem i aftë të punoj.

Por mbi të gjitha kam mësuar ta vlerësoj jetën. Dua ta mbyll këtë rrëfim të shkurtër me një shprehje nga Shën Tereza e Kalkutës:

**“Sa rrini duke qarë errësirën,
ndizni një qiri”**

Vetëvlerësimi i personave me aftësi ndryshe

Vetëvlerësimi është se si e vlerësojmë ne veten tonë, se si e perceptojmë vlerën tonë në këtë botë dhe sa të vlefshëm mendojmë se jemi ne për të tjerët. Vetëvlerësimi ndikon besimin tonë në të tjerët, marrëdhëniet tona, punën tonë, pothuajse çdo pjesë e jetës tonë. Për personat me aftësi të kufizuara që kanë vetëvlerësim të ulët Ju jeni të vlefshëm, jo të pavlerë. Një bekim për të tjerët, jo një barrë. Më e rëndësishmja, ju jeni një dhuratë nga Zoti. Kushdo që ju thotë ndryshe, janë të gabuar. Ju keni të drejtë për një jetë të bekuar, ashtu si të gjithë njerëzit. Ju do ju duhet të punoni pak më shumë se të tjerët për të marrë gjërat që dëshironi, por kjo nuk do të thotë që ju nuk mund t'i merrni këto gjëra. Më poshtë kam sugjeruar disa mënyra për të rritur vetëvlerësimin tuaj dhe për të marrë kontrollin e jetës tuaj. Kjo nuk do ndodhi brenda natën, por nëse vazhdoni ta praktikoni dhe mbani mend këto hapa, ju jo vetëm do të rrisni vetëvlerësimin, por do të ndihmoni edhe të tjerët. Gjeni një komunitet mbështetës. Të jesh me njerëz të cilët të mbështesin do t'ju fuqizojë të merrni kontrollin e jetës.

Kërkoni grupe me njerëz që janë si ju ose krijoni grupin tuaj nëse nuk e gjeni dot atë që iu përshtatet. Përqëndrohuni në aftësitë tuaja më shumë se në kufizimet tuaja. Kjo nuk do të thotë se ju nuk e pranoni se keni një paaftësi, por përkundrazi duke u fokusuar në aftësitë tuaja ju do ndiheni mirë me gjërat që mund të bëni. E di që kjo mund të jetë e vështirë, por do i ndihmojë të tjerët të kuptojnë nevojat dhe dëshirat tuaja. Përqëndrohuni në pikat e forta dhe jo në ato të dobëta. Provojeni në këtë mënyrë: Mendoni për gjërat që keni bërë ose për të bërë. Shkruani ato dhe vazhdoni të bëni gjërat që janë të mira ose që keni për të bërë. Kjo do ju bëjë të ndiheni më të sigurtë. Mos harroni që askush nuk është i përsosur dhe secili bën gabime. Nëse keni një ditë të keqe ose bëni diçka gabim, mos u shqetësoni, ju po bëni më të mirën që mundeni për të jetuar jetën. Kujtoni gjithmonë që ju nuk jeni një barrë, prandaj mos kini frikë të kërkoni ndihmë. Të gjithë kanë nevojë për ndihmë, prandaj mos keni turp të kërkoni ndihmë kur keni nevojë. Është më mirë se të luftosh gjithçka vetë.

Të njohim veten



Njohja e vetes është një proces shumë i rëndësishëm.

Duke njohur veten tonë ne mund të dimë ku jemi të aftë dhe ku nuk jemi.

Pasi të kemi mësuar se ku jemi të fortë e ku të dobët
ne do mund të punojmë aty ku ne ndihemi të fortë.

Për personat me aftësi të kufizuara kjo është shumë e rëndësishme.
Ata duhet të gjejnë sa më herët pikat e tyre të forta dhe ti praktikojnë ato.

Sa më herët që kjo të ndodhë, aq më mirë do të jetë për ta.

Duke i ditur që të vegjël pikat e tyre të forta,
personat me aftësi ndryshe do e kuptojnë që ata janë të aftë.

Duke u arsimuar ashtu si duhet personat me aftësi ndryshe do të rrisin
mundësitë për punësim dhe për të qenë aktiv në shoqëri.

Çdo gjë mund të arrihet, mjafton të njohim veten...

Përgatiti: Albina Dragusha

Eskursion me fëmijët

Në qendrën ditore përveç se mësojmë gjëra
që janë të rëndësishme për ne,
kalojmë edhe bukur duke u argëtuar
dhe duke kaluar momente të bukura së bashku.

Kështu që ne vendosëm të kryenim
një eskursion në Ishëm.

Në këtë eskursion ne patëm mundësinë
të shikojmë nga afër kalanë e Ishmit,
të mësojmë rreth historisë së saj
dhe të shijojmë natyrën.

Gjatë këtij eskursioni ne folëm
për rëndësinë që ka respektimi i natyrës,
por dhe i historisë tonë.

Ne kryem biseda duke shprehur dëshirat tona,
por edhe duke ndarë përvojat tona
nga udhëtime të ndryshme.

Gjithashtu ne kryem edhe ecje në mal
duke shijuar çdo moment..

Përgatiti: Darjan Konomi

Një rrëfim i singërtë për vajzën time, Aleksandrën!

Unë ju rrëfej historinë më të dhimbshme dhe më të bukur të jetës sime. Ja si fillon sprova më e madhe e jetës.

Më 3 shtator 1997

linda të bukurën time, Aleksandrën. Ishte një femijë aq i bukur sa për herë të parë kur e mora në krahë qava shumë saqë ndoshta po e parandjeja se diçka do të ndodhte.

Kaluan 6 muaj pas lindjes së Aleksandrës dhe akoma nuk dija asgjë.

Vajza ime ishte e sëmurë atë natë, e në mes të natës e dërgova në spitalin e Shkodrës, aty mësova që ime bijë vuante nga Sindroma Down.

E dërgova në kopshtin e lagjes por nuk ma pranuan.

Mundësisht me përbuzjen më të madhe, me fjalët më të rënda duke më thënë:

“Nuk pranojmë në shkollë një fëmijë budalla”.

Kaluan 16 vite dhe Sandra ime rrinte vetëm brenda, e izoluar, nuk donte të rrinte me asnjëri. Ajo gjithmonë mbante në duar një kukull që ishte si një shoqe për të që akoma e mban edhe sot.

Por mbas gjithë këtyre vuajtjeve, lotëve, sakrificave vendosa që të merrja një hap tjetër pa e ditur a do të kisha sukses.

Veç shpresova në Zotin.

Kur Sandra ishte vetëm 17 vjeç shkova në Vau Dejës dhe fola me

drejtorin dhe përgjegjës të Caritas-it duke i shpjeguar situatën e vajzës sime. Ata më folën mbi projektin “Pa Barriera”.

Pas 2 ditëve ata erdhën tek shtëpia ime dhe takuan Aleksandrën. Duke i falenderuar pa masë, ata morën një nismë të re në lidhje me bijën time.

Duke e aktivizuar në aktivitete të ndryshme, për Aleksandrën u krijua një jetë e re plot ngjyra.

Ka mësuar të pikturojë, të njohë ngjyrat, numrat, format sipas madhësive, të shoqërohet me njerëz, të qeshë, të flasë, të shprehë mendimet e saj. I falenderoj pa masë stafin e Caritas-it, vullnetarët edhe psikologun e saj.

Sot vajza ime është 20 vjeç dhe vitet e fundit një rreze drite ka rënë në fytyrën e saj dhe në timen, më parë ajo rrinte veç në dhomën e saj aq e heshtur dhe pasive, por sot?!

Sot ajo përpiket të jetë më aktive se kurrë.

“Ju them të gjithë prindërve, të gjitha nënave që asgjë në këtë botë,

Zoti nuk e bën pa një arsye.

Ju lutem mos qani, mos vuani pasi ka gjithmonë një dritë në fund të tunelit.

Pranojeni ëngjëllin tuaj dhe kurrë mos e braktisni në duart e dikujt tjetër.

Pranojeni dhuratën e Atit tonë.

Faleminderit të gjithë atyre që kanë kontribuar për buzëqeshjen e Aleksandrës.

Faleminderit juve që do të lexoni këtë rrëfim të shkurtër dhe pse jo, do ta ndani dhimbjen bashkë me mua”

Prindi: Flora Lasku

WITH FUNDING FROM

 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Kursi i rrobaqepsisë

Kursi i rrobaqepsisë zhvillohet 3 herë në javë me 7 vajza me aftësi ndryshe.

Vajzat në fillim janë njohur me proceset e thjeshta të rrobaqepsisë.

Në fillim mësuam vendosjen e perit në gjilpërë dhe qepjen me dorë.

Pastaj vazhduam me mësimin e përdorimit të hekurit të rrobave.

Përdorimi i gërshërëve dhe prerja e copave me gërshërë është një proces i vështirë që kërkon ndihmë nga një person tjetër për shkak të vështirësisë që kanë në koordinimin e duarve.

Disa nga vajzat kanë mësuar të përdorin makinën qepëse me korrent.

Në kursin e rrobaqepsisë janë realizuar produkte të ndryshme.

Janë realizuar mbulesa tavoline të thjeshta dhe me zbukurime, përparëse kuzhine, kapele kuzhine.

Përgatiti: Drita Caka



Si të kujdesemi për dhëmbët

Ne duhet të kujdesemi për dhëmbët çdo ditë në mënyrë që të mos kemi problem me dhëmbët, mishin e dhëmbëve dhe gojën. Dhëmbët duhet të lahen të paktën dy herë në ditë, pas ngrënies së mëngjesit dhe në darkë para se të flini gjumë. Përdorni furçë me fije të buta. koka e furçës duhet të jetë aq e vogël sa të futet në të gjithë pjesët e gojës. Furça duhet të ndërrohet çdo 3 - 4 muaj dhe asnjëherë nuk duhet të përdorni furçat e të tjerëve.

Pastrimi para fjetjes është shumë i rëndësishëm pasi lufton bakteriet që mund të zhvillohen nga mbetjet e copëzave të ushqimit dhe goja mbetet e pastër gjatë gjithë kohës që flini.

Procesi i larjes së dhëmbëve duhet të zgjasë 2 – 3 minuta.

Si duhen larë dhëmbët?

Në fillim, shpërndani pastën në dhëmbë dhe filloni të lani dhëmbët ngadalë, duke patur kujdes që dhëmbët tuaj të lahen deri tek qafa e dhëmbit.

Kur lani dhëmbët duhet të keni parasysh, që t'i lani mirë në sipërfaqen ku kafshohet. Secili nga ne duhet të kujdeset, në mënyrë që të mos harrojë asnjë dhëmb pa e larë.

Edhe në gropëzat e dhëmballëve duhet ta përdorni mirë furçën në mënyrë që të hiqen të gjitha copëzat e ushqimit të mbetur.



Pasi keni mbaruar së lari dhëmbët, mund t'i kontrolloni dhëmbët me gjuhë nëse janë larë mirë.

Disa këshilla për një shëndet sa më të mirë të gojës

Zgjidhni ushqime si: bukë, fruta, perime, peshk, qumësht, djathë, kos, etj.

Përdorni ujë pas ushqimit.

Mos hani ushqime të thata dhe me shumë sheqer.

Përdorni furcen e dhëmbëve 2-3 herë në ditë. Pakësoni marrjen e sheqernave gjatë ditës. Bëni kontrolle tek dentisti cdo 6 muaj.

Përgatiti: Moneda Ujka

Edukimi bazë

Ndërhyrja në edukimin bazë tek fëmijët me nevoja të veçanta kërkon një strategji pune të veçantë;

- Fëmijët duhet të mësojnë shkronjat, numrat.
- Fëmijët duhet të njohin ngjyrat,
- Duhet të mësojnë muajt dhe stinët e vitit,
- Duhet të njohin monedhat dhe t'i përdorin ato,
- Duhet të dinë të dhënat personale,
- Duhet të njohin nocionet e kohës (mëngjes, drekë, darkë).
- Fëmijët të ushtrohen për të njohur institucione të ndryshme (komuna, shkolla, kisha, dyqane, qendra shëndetësore etj.)
- Të njohin rregullat e mirësjelljes.
- Të njohin dhe të ruajnë mjetet e punës.
- Të bashkëpunojnë në grup dhe të respektojnë njëri-tjetrin.



Përgatiti: Lindita Prendi

Caritas Shqiptar Rruga “Don Bosko”, Nr 4 Tiranë-Shqipëri Tel. +355 4 223 00 88; Fax: +355 4 223 43 27
e-mail: caritasalbania@cartiasalbania.org www.caritasalbania.org

Redaktoi: Elona Memetaj

Dizenjimi dhe faqosja: Ladybird

